



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1118/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcı anëtarw, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë - dega në Viti, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë - dega në Viti, vendosje e materialit zgjedhor në hapësire publike - shtylla elektrike, për raundin e Dytë për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datë 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 15.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e paraqitur nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë-dega në Viti, dhe Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë - dega në Viti, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 1,200.00 (një mijë e dyqind) euro, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët-vendosja e materialit zgjedhor në hapësire publike - shtylla elektrike.

II. Detyrohet Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

A r s y e t i m

PZAP me datën 13.11.2021, ka pranuar ankesën me numër Anr.1118/2021, nga Subjekti Poltik Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilën ndër të tjera pretendon se aktivistet e tyre me datën 13.11.2021 rreth orës 12:00 në fshatin Verban në Komunën e Vitisë, kanë vërejtur se Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, kandidati për kryetar të Komunës së Vitisë, Arsim Ademi nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, ka vendosur material zgjedhore në hapësira publike në mes të shtyllave elektrike, andaj kërkojnë nga PZAP që ky veprim të sanksionohet sipas dispozitave ligjore.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore, ankuesi ka bashkangjitur një fotografi, nga vendi ku ka ndodhur shkelja.

PZAP-i me datën 13.11.2021 e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje, me ankesën e parashtruar dhe kërkoi nga e njëjta që deri me datën 14.11.2021 në orën 10:00, të përgjigjet në ankesë.

Në përgjigjen në ankesë, të Subjekti Politik, Lëvizja Vetëvendosje, të datës 14.11.2021 theksojnë se baneri në fjalë nga lokacioni që shihet në fotografi është hequr me datën 11.11.2021, dhe konstatimi i palës ankuese se aktivistët e saj e kanë vërejtur banerin në fjalë me datën 13.11.2021 është i pa bazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje për qëllime elektorale në fshatin Verban në Komunën e Vitisë përkatësisht në mes të shtyllave elektrike mbi rrugë ka vendosur material zgjedhor poster të kandidatit të tyre për Kryetar të Komunës së Vitisë Arsim Ademi, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 paragrafi 1 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e njoftimeve, pllakatave dhe posterave, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut etj.”.*

Pretendimi si në përgjigjen në ankesë, se nuk është kontestues fakti se baneri i lartë cekur është larguar me datën 11.11.2021 nuk arsyeton vendosjen e tij në kohë të fushatës, kur secili veprim i secilit kandidat për kryetar, apo kuvend komunal nga cilido subjekt politik hynë në kategorinë e veprimeve të ndaluara të Kodit të Mirësjelljes të cekur më lartë, e të cilat veprime sanksionohen. Qëllimi i sanksionimit të këtyre veprimeve ka të bëjë me ruajtjen e neutralitetit të pasurisë apo pronës publike, si pasuri e të gjithëve pa dallim.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit politik LVV, në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se Subjekti Politik LVV ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës. Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik LVV, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtat ishin jo relevante dhe pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendosë dhe se nuk kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika c) të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.1118/2021 me datën 15.11.2021

Kryesuese e Panelit
Milena Đerić



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa komfor nenit 118 par 4 të LZP-së.